



**OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

**Drejtuar: OE “Intelligent Building Solution (I.B.S.)” sh.p.k., me NIPT L61411012R**

Adresa: Rruga Fortuzi, (ish rruga Maliq Muca), Pallati 50, Ap. 4, Tiranë.

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me mjete elektronike – Punë.

**Numri i referencës së procedurës:** REF-92236-12-27-2023

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Mirëmbajtje e ambienteve të Administratës Qendrore të OST sh.a.”.

**Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):** Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 105, datë 29.12.2023.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. OE “NIKA” sh.p.k.**

**me NIPT J76705047U**

Vlera 8,373,809.22 (tetë milion e treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntë pikë njëzet e dy) Lekë pa TVSH.

**2. BOE “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k.**

**me NIPT L41513008A**

**“ASI-2A CO” sh.p.k.**

**me NIPT K53002402C**

Vlera 8,827,927.47 (tetë milion e tetëqind e njëzet e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e shtatë pikë dyzet e shtatë) Lekë pa TVSH.

**3. OE “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k.**

**me NIPT K66613407H**

Vlera 9,088,185 (nëntë milion e tetëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH.

**4. BOE “J O G I” sh.p.k.**

**me NIPT J63229478K**

**“S P E K T R I” sh.p.k.**

**me NIPT J62903555F**

Vlera 9,164,740 (nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e dyzet) Lekë pa TVSH.

**5. OE “Intelligent Building Solution (I.B.S.)” sh.p.k. me NIPT L61411012R**

Vlera 9,180,216.59 (nëntë milion e njëqind e tetëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH.

**6. OE “T & XH” sh.p.k.**

**me NIPT L72121504I**

Vlera 9,919,047.6 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë dyzet e shtatë pikë gjashtë) Lekë pa TVSH.

**7. OE “SARK” sh.p.k.**

**me NIPT K52531415H**

Vlera 10,288,521 (dhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e njëzet e një) Lekë pa TVSH.

**8. OE “ZEQILLARI” sh.p.k.**

**me NIPT L61912024O**

Vlera 10,421,082.46 (dhjetë milion e katërqind e njëzet e një mijë e tetëdhjetë e dy pikë dyzet e gjashtë) Lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. OE “NIKA” sh.p.k., me NIPT J76705047U, për arsye se:**

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.8, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi punonjësit e deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur, si dhe në sqarimet e dhëna në SPE, nuk korrespondojnë të njëjtë në listëpagesën e paraqitur, referuar parashikimeve të VKM Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, konkretisht:

1. Punonjësi “bojaxhi” i deklaruar me inicialet L. M. është i regjistruar nga OE si “Elektro-mekanik”.
2. Punonjësi “marangoz” i deklaruar me inicialet A. N. është i regjistruar nga OE si “Elektriçist”.
3. Punonjësi “saldator” i deklaruar me inicialet H. M. është i regjistruar nga OE si “Bojaxhi për dru”.

Për punëtorin e deklaruar me inicialet D. L., në rolin e teknikut të ndërtimit, nuk është paraqitur dëshmi apo diplomë për të vërtetuar se zotëron këto aftësi, si dhe në CV e tij nuk ka të përshkruar asnjë të dhënë për këtë pozicion, në përmbushje të kriterit 2.3.8, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, ku specifikohet:

*“Përveç si me sipër, për punonjësit teknik ndërtimi duhet te paraqitet dokumenti qe vërteton kualifikimin (dëftesë dhe/ose diplomë).”*

Gjithashtu, punonjësit e deklaruar dhe për të cilët janë paraqitur dokumentet e dëshmive të sigurimit teknik, rezultojnë që nuk përmbushin periudhën e kërkuar prej 6 (gjashtë) muajve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, ku siç rezulton, shumica e tyre janë certifikuar me datë 08.01.2024, një ditë përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit.

**2. BOE “APIS CONSTRUCTION” sh.p.k., me NIPT L41513008A & “ASI-2A CO” sh.p.k., me NIPT K53002402C, për arsye se:**

Nuk ka përmbushur pikën 2.2.1, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur kopje të certifikuara të bilanceve, për të vërtetuar se të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, sipas kërkesës së këtij kriteri dhe nenit 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.8, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, edhe pas dhënies së sqarimeve dhe dokumenteve të kërkuara, në përputhje me parashikimet e pikës 7, të nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, rezulton se nuk disponon apo zotëron dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të, të vlefshme, sipas kërkesës, konkretisht për punonjësit F. Z., E. Sh., L. P., Gj. K., S. H., S. Gj., si dhe nuk ka paraqitur listëpagesat e periudhës së kërkuar.

**3. OE “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k., me NIPT K66613407H, për arsye se:**

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.8, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, pas paraqitjes së sqarimeve referuar kërkesës për sqarim të Autoritetit Kontraktor, rezulton se për punonjësit P.C. dhe D. M., dëshmitë janë marrë pasi është zhvilluar procedura e prokurimit dhe është paraqitur kërkesa për sqarim nga Autoriteti Kontraktor.

**4. BOE “J O G I” sh.p.k., me NIPT J63229478K & “S P E K T R I” sh.p.k., me NIPT J62903555E, për arsye se:**

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.8, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, nuk ka deklaruar se disponojnë apo zotërojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të, të vlefshme, sipas kërkesës, si dhe nuk i është përgjigjur kërkesës së Autoritetit Kontraktor në SPE, për të dhënë informacion për të dhënat e deklaruara në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në përputhje me parashikimet e pikës 7, të nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.9, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi për kamionin e kërkuar në këtë pikë, nuk ka specifikuar kapacitetin mbajtës në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

**5. OE “SARK” sh.p.k., me NIPT K52531415H, për arsye se:**

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.1, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi vlera totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës është në vlerën 6,382,674 Lekë, ndërkohë që në këtë kriter kërkohet të arrihet vlera 11,000,000 Lekë. Dokumentacioni mbi kontratën e realizuar me AK “Bashkia Korçë” është i paplotë, pasi nuk janë paraqitur vërtetime të lëshuara nga ky ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, sipas kërkesës së përcaktuar në këtë kriter dhe në pikën 5, të nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.5, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk disponon 20 punonjës me kohë të plotë pune, të siguruar të paktën për 6 (gjashtë) muajt e

fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, sipas vërtetimit të paraqitur “Listepagesa\_Tetor\_2023” nga ku rezulton se në këtë muaj janë 18 punonjës të siguruar.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.8, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, nuk ka deklaruar se disponojnë apo zotërojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të, të vlefshme, sipas kërkesës. Edhe pas kërkesës për sqarim të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, OE ofertues nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për të përmbushur këtë kriter, por vetëm ka paraqitur një shkresë ku deklaroi se po paraqet informacion bashkëlidhur, ndërkohë që mungon ky dokumentacion bashkëlidhur.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.9, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka përcaktuar sasitë e mjeteve që disponon, sipas kërkesës së këtij kriteri.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.9/5, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku pranon se Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “Intelligent Building Solution (I.B.S.)” sh.p.k., me NIPT L61411012R**, Adresa: Rruga Fortuzi, (ish rruga Maliq Muca), Pallati 50, Ap. 4, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **9,180,216.59 (nëntë milion e njëqind e tetëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve të OST sh.a., me adresë Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë - Durrës, Km. 9, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10 (dhjetë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar dhe tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

**ADMINISTRATORI I OST SH.A.**

**Skerti Drenova**